



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.02.2021, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mirela Kumbaro – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Përzgjedhja e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant për kryetar të KDRTSH-së, i krijuar nga mbarimi i mandatit (*mbledhja vijon me dyer të mbyllura*).

Marrin pjesë:

Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

Mungojnë:

Ramazan Gjuzi, Enada Kapllani.

Kandidaturat:

- 1.Klevis Bejkolli
- 2.Gëzim Podgorica
- 3.Gaspër Marku
- 4 Ksenofon Kristafi
- 5.Nadia Rusi (Peto)
6. Leka Bungo

HAPET MBLEDHJA

Mirela Kumbaro – Mirëmëngjesi, të dashur kolegë!

Mbledhjen po e zhvillojmë në kushte *online*, por edhe drejtimin, ndryshe nga herët e tjera, do ta zhvillojmë *online*, për shkak se kryetari i komisionit, zoti Ramazan, është me Covid. I urojmë të gjithë të shkuara! Zoti Gjuzi e ka të pamundur të jetë edhe në Kuvend, edhe *online* për shkak të gjendjes së tij, ndaj mbledhjen do ta drejtoj unë, në cilësinë e nënkryetares. Do ta drejtoj mbledhjen *online*, duke falënderuar për bashkëpunimin stafin e komisionit, sekretarinë dhe këshilltarët, duke i përshëndetur nga Përmeti. Pa humbur kohë, vazhdojmë me mbledhjen.

Siç jeni njoftuar nga sekretaria nëpërmjet *email*-it, sot në rendin e ditës kemi përzgjedhjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant për kryetar të Këshillit Drejtues të RTSH-së, që është krijuar nga mbarimi i mandatit të kryetarit pararendës.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, verifikojmë kuorumin. Prezentë janë: Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Erion Piciri dhe Amra Barova. Kuorumi i nevojshëm për të vazhduar mbledhjen plotësohet.

Atëherë, në rendin e ditës kemi përzgjedhjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant për kryetar të Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Edhe një herë ju kujtoj që të shënohet në procesverbal se për këtë fazë, duke qenë se ka të bëjë me përzgjedhje emrash konkrete, duke respektuar traditën dhe precedentët që kemi krijuar tashmë në komision dhe që në të tilla raste mbledhjet i kemi zhvilluar me dyer të mbyllura, me qëllim që të mos kemi cenim të integritetit të tyre gjatë procesit të seleksionimit të dokumenteve, pra, edhe kjo mbledhje do të zhvillohet me dyer të mbyllura. Unë gjykoj dhe dua të theksoj se kjo është një praktikë e mirë, e cila duhet të respektohet edhe në këtë rast, prandaj, bazuar në nenin 35, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, propozoj që kjo pjesë e mbledhjes të zhvillohet me dyer të mbyllura. Kush është dakord? Dakord!

Miratohet.

U fut në linjë tani edhe zoti Jenishehri.

Mbledhja vijon me dyer të mbyllura

